

**VENDIM**  
**Nr.511, datë 30.7.2004**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.182, DATË 25.4.1995 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR ÇMIMET E SHITJES SË BARNAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”, të ndryshuar, dhe të nenit 5 të ligjit nr.9135, datë 11.9.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 4 të vendimit nr.182, datë 25.4.1995 të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 4/1, 4/2 e 4/3 si më poshtë vijon:

“4.1 Barnat që hidhen në treg dhe qarkullojnë në Republikën e Shqipërisë, kanë të vendosur mbi kutinë e ambalazhit një pullë, për efekt kontrolli, si provë e regjistrimit të tyre, e marrjes së autorizimit për hedhjen e tyre në treg dhe për respektimin e çmimit përfundimtar të shitjes. Pulla e kontrollit i jepet subjektit fabrikues të barnave në Republikën e Shqipërisë ose subjektit shitës me shumicë të barnave nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave, kundrejt pagesës, për çdo seri të barit të fabrikuar në vend ose të importuar.

a) Pulla e kontrollit përmban në mënyrë të detyrueshme këto të dhëna:

- emërtimin e barit;

- formë-dozën;

- serinë e prodhimit të barit;

- emrin e fabrikuesit/të importuesit të barit në Republikën e Shqipërisë;

- çmimin e shitjes me pakicë të barit;

- emërtimin e autoritetit që lëshon pullën: Qendra e Kombëtare e Kontrollit të Barnave.

Katër nënpikat e para të shkronjës “a” mund të shprehen në mënyrë të shifruar, me përjashtim të dy nënpikave të fundit, të cilat duhen shprehur me fjalë.

b) Pulla e kontrollit vendoset prej subjektit fabrikues të barnave dhe subjektit shitës me shumicë të barnave mbi kutinë ambalazhuese të barit. Ajo i referohet deklaratimit të fabrikuesit ose shitësit me shumicë të barit dhe autorizimit për hedhjen në treg, për çdo seri të veçantë.

4/2. Hedhja në treg, shitja me shumicë dhe me pakicë e barnave nga subjektet pa pullën e kontrollit përbën shkelje të rregullave të fabrikimit e të tregtimit dhe ndëshkohet sipas neneve 53 e në vijim, të ligjit nr.7815, datë 20.4.1994 “Për barnat”, të ndryshuar.

4/3. Barnat e hedhura në treg dhe që janë në qarkullimin brenda 90 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të pajisen me pullën e kontrollit.”.

2. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**